



**AGJENCIA PËR INFORMIM DHE PRIVATËSI
NËN LLUPËN E INPO-S**



Agjencia për Informim dhe Privatësi nën Ilupën e INPO-s

Raport i monitorimit të punës së Agjencisë për Informim dhe Privatësi

Prishtinë, Maj 2024

Autor: Leorenta Alija dhe Ebru Zborça

Redaktor: Albulena Nrecaj - Musliu

Të gjitha të drejtat e këtij botimi i takojnë organizatës Iniciativa për Progres – INPO. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të printohet, distribuohet, kopjohet, shumëfishohet në çfarëdo forme apo mënyrë, elektronike ose të shtypur, pa pajtimin paraprak të organizatës Iniciativa për Progres. Të drejtat dhe prona intelektuale e këtij botimi mbrohen me Ligjin nr.04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta të Republikës së Kosovës.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e organizatës Iniciativëa për Progres – INPO dhe ajo nuk pasqyron qëndrimet e Rockefeller Brothers Fund.

Përkrahur nga:



Përmbajtja

1. Lista e shkurtesave.....	5
2. Hyrje	6
3. Agjencia për Informim dhe Privatësi	7
3.1. Korniza ligjore vs praktika.....	10
4. Pasqyrë e përgjithshme statistikore e ankesave të paraqitura dhe të trajtuara nga AIP	12
4.1. Cilësia dhe konsistenca e vendimeve të AIP	14
4.1.1. INPO vs Komuna e Gjilanit vs AIP	16
5. Rasti i Flutura Kusari “ <i>sfidë</i> ” për AIP-in.....	19
6. Ndikimi i INPO-s në ngritjen e transparencës dhe llogaridhënies	20
7. Konkluzione dhe Rekomandime	22

I. Lista e shkurtesave

AIP - Agjencia për Informim dhe Privatësi

INPO - Iniciativa për Progres

LQDP - Ligji për Qasje në Dokumente Publike

BE - Bashkimi Evropian

MAPL - Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

MMPHI - Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapsinorë dhe Infrastrukturës

LLPA - Ligji për Proceduren e Përgjithshme Administrative

LOFASHAP - Ligji për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura

2. Hyrje

Kjo analizë është një vlerësim i punës së Agjencisë për Informim dhe Privatësi (tutje AIP), për vitin 2023, e cila si agjenci e pavarur fokusin e saj e ka në dy fusha kryesore, si: mbrojtja e të dhënave personale dhe qasja në dokumente publike. Përmbajtja e kësaj analiza është e ndarë në dy pjesë: pjesa e parë trajton aspektet e përgjithshme të punës së AIP-it në shtyllën e qasjes në dokumente publike dhe pjesa e dytë është e fokusuar në trajtimin e rasteve apo ankesave të deponuara nga INPO në AIP, respektivisht eksperiencës së INPO-s me AIP-in.

E drejta për qasje në dokumente publike në Kosovë është garantuar me kushtetutë dhe legjislacion përkatës për zbatimin e plotë të saj. Krahas avancimeve dhe rregullimeve ligjore Kosova ende është duke u përballur me sfida të shumta në këtë fushë. Mungesa e llogaridhënies së institucioneve publike karshi qytetarëve dhe publikut vazhdon të jetë pengesë e madhe për transparencën dhe llogaridhënien në qeverisje. Prandaj, duke marrë parasysh që rritja e nivelit të qasjes në dokumente publike do të ndikojë në rritjen e llogaridhënies institucionale, hulumtimi përqëndrohet në rolin dhe rëndësinë e institucionit kryesor AIP, si përgjegjëse për mbikqyrjen, zbatimin si dhe garantimin e qasjes në dokumente publike. Ndryshe, mungesa e transparencës nga institucionet publike krijon hapsirë rreth dyshimit për korrupsion dhe keqpërdorim të pozitës zyrtare.

Duke konsideruar që ushtrimi i së drejtës për qasje në dokumente publike ofron një burim informacioni për publikun dhe ndihmon në rrijten e integritetit, efikasitetit dhe përgjegjshmërisë e autoriteteve publike ekziston nevoja për një qasje proaktive dhe bashkëpunim të ngushtë ndërmjet qeverisë dhe shoqërisë civile për promovimin e transparencës në këtë drejtim. Prandaj, duhet pranuar se e drejta për informim nuk është as pika e fillimit dhe as e fundit. Shoqëria civile dhe vullneti politik janë thelbësore në ndërtimin e një kulture të qëndrueshme të qasjes në informacion.

Kështu që, kjo analizë do të trajtoj legjislacionin aktual për qasje në dokumente publike si dhe problemet kryesore apo barrierat e hasura gjatë rrugës sa i përket përmbushjes së obligimeve ligjore të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike.

Në fund, kjo analizë është përcjellur për komente në Agjencinë për Informim dhe Privatësi dhe komentet e këtij institucioni janë pjesë e kësaj analize.

3. Agjencia për Informim dhe Privatësi

“Secili person gëzon të drejtën të qasjes në dokumente publike”, kështu thotë Kushtetuta e Republikës së Kosovës e cila obligon institucionet në ofrimin e plotë të qasjes në dokumente publike, ndërsa në rast të pretendimeve për kufizim të saj bën përgjegjës pas parashtrimit të ankesës AIP-in për ofrimin e plotë të qasjes, ndaj institucioneve të cilat nuk respektojnë Kushtetutën dhe Ligjin për Qasje në Dokumente Publike. Në këtë rast me qëllim të zbatimit në plotëni të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike dhe ofrimin të plotë të qasjes në dokumente publike, sikurse në praktikën ndërkombëtare, është krijuar institucioni i Agjencisë për Informim dhe Privatësi, si agjenci e pavarur për zbatimin dhe mbikqyrjen e dy fushave të ndjeshme, saktësisht qasjen në dokumente publike dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

AIP, e ashtuquajtur Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në kohën e themelimit të saj në vitin 2010, buron nga Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale i miratuar në vitin 2010, si institucion përgjegjës për mbikqyrjen e zbatimit të rregullave për mbrojtjen e të dhënave personale.¹ Tutje, me shfuqizimin e Ligjit nr. 03/L-172 për mbrojtjen e të dhënave personale në vitin 2019, dhe miratimin e Ligjit nr. 06/L-082 për mbrojtjen e të dhënave personale, agjencisë përveç ndryshimit të emrit të institucionit, dhe mbrojtjes së të dhënave, i'u shtua edhe përgjegjësia për mbikqyrjen e zbatimit të legjislacionit për qasje në dokumente publike.² AIP si agjenci e pavarur, është themeluar me qëllim që të mbrohen të drejtat dhe liritë themelore të personave fizik, në lidhje me përpunimin e të dhënave personale, si dhe garantimin e qasjes në dokumente publike, gjersa e njëjta funksionon mbi bazën e një strukture ku përfshihen dy departamentet kryesore për mbrojtjen e të dhënave si dhe qasja në dokumente publike.³

Ndërsa, me qëllim të avancimit të transparencës dhe llogaridhënies që nga themelimi i AIP-it, përveç legjislacionit primar, ky institucion ka miratuar edhe një varg rregulloresh dhe udhëzimesh sa i përket qasjes në dokumente publike të cilat do të trajtohen një nga një në kapitullin në vazhdim se si dhe sa respektohet legjislacioni primar dhe sekondar, në raport me të drejtën e informimit.

Kjo e drejtë, praktikisht qasja në dokumente publike, i jep mundësinë çdo personi fizik që të marrë informacion për të gjitha veprimet dhe vendimet të cilat rrjedhin nga një institucion i caktuar publik, qoftë qendror apo lokal. Në këtë drejtim, publikimi i të gjitha dokumenteve të cilat burojnë si rezultat i vendimeve të marra supozohet të publikohen ashtu si i obligon legjislacioni respektiv, si dhe Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për administratë të hapur në komuna⁴ për

¹ Ligji nr. 03/L-172 për mbrojtjen e të dhënave personale i shfuqizuar më 2019 me Ligji nr. 06/L-082 për mbrojtjen e të dhënave personale, i qasshëm, në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18616>

² Për më shumë shih Ligji nr. 06/L-082 për mbrojtjen e të dhënave personale, i miratuar në vitin 2019, i qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18616>

³ Për më shumë shih Organogramin e Agjencisë për Informim dhe Privatësi, i qasshëm në: <https://aip.rks-gov.net/per-ne/struktura-e-aip-se/organogrami/>

⁴ Për më shumë shih Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për administratë të hapur në komuna, i miratuar më 21.12.2023, i qasshëm në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=31852>

nivelin lokal dhe Udhëzim Administrativ (MAP) nr. 01/2015 për ueb faqet e institucioneve publike.⁵ Mirëpo, përderisa këto dy udhëzime administrative nuk respektohen qytetarët e kanë të vështirë të qasen në dokumente dhe informata të cilat duhet të jenë lehtësisht të qasshme përmes ueb faqeve zyrtare të institucioneve, kërkesat për qasje në dokumente publike do të duhej të trajtoheshin me seriozitet dhe prioritet. Për kërkesat e refuzuara apo rreth kufizimit të qasjes informacione paraqitja e ankesës pranë AIP, rregullohet me nenin 20 të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike dhe mbetet tërësisht në diskrecion të AIP për të proceduar me shqyrtimin administrativ të ankesës.

Në anën tjetër, “Qasja në informacionin e mbajtur nga administrata do të lehtësohet nga fuqizimi i përgjegjësive të Agjencisë për Informim dhe Privatësi (AIP), së cilës do t'i besohen mjete mbikëqyrëse më efektive dhe me përmirësime në mbledhjen e të dhënave dhe statistikave në lidhje me qasjen në informacion nga administrata shtetërore”,⁶ thuhet në Strategjinë e Reformës së Administratës Publike 2022-2027 i cili është dokument kryesor strategjik i qeverisë, nga i cili derivojnë objektiva dhe udhëzime për modernizimin dhe reformimin e administratës publike. Në këtë kontekst, për të arritur këtë prioritet strategjik vërehet se Qeveria e Republikës së Kosovës nuk është duke trajtuar me rëndësi fuqizimin e rolit të AIP-it dhe rritjen e cilësisë në ofrimin e shërbimeve publike dhe administrative si dhe zvogëlimin e barrës administrative.

Tutje, AIP si institucion i pavarur është e obliguar që të hartoj edhe një plan të performancës institucionale sipas Ligjit për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura.⁷ Në të njëjtën kohë, Rregullorja mbi Sistemin e Menaxhimit të Performancës për Agjencitë në kuadër të Administratës Shtetërore përcakton rregullat dhe procedurat për sistemin e menaxhimit të performancës së agjencive ekzekutive dhe rregullatore në kuadër të administratës shtetërore. Përmes kësaj rregullore janë adresuar çështjet e formës dhe përmbajtjes së Planit Vjetor të Performancës si dhe procesi i hartimit të saj.⁸

INPO për të pasqyruar gjendjen aktuale në këtë institucion ka analizuar edhe Planin e Performancës së AIP për vitin 2024 ku janë përcaktuar objektiva të ndryshme për sigurimin dhe jetësimin e së drejtës për qasje në dokumente publike. Objektivi 2, i Planit të Performancës ka paraparë: “Monitorimin e zbatimit të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike dhe inicimin e programit të transparencës për publikimin pro-aktiv të informatave dhe dokumenteve nga Institucionet Publike”.⁹ INPO vlerëson se AIP në kuadër të detyrave dhe kompetencave të saj si obligim kryesor e ka

⁵ Për më shumë shih Udhëzimin Administrativ (MAP) nr. 01/2015 për ueb faqet e institucioneve publike, i miratuar më 13.05.2015, i qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11007>

⁶ Për më shumë shih strategjinë e RAP, i qasshëm në: <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/01/STRATEGJIA-E-REFORMES-SE-ADMINISTRATES-PUBLIKE-2022-2027.pdf>

⁷ Për më shumë shih nenin 30, të Ligjit për Agjencitë e Pavarura, i qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18684>

⁸ Për më shumë shih Rregullorën (QRK) NR. 12/2023 mbi Sistemin e Menaxhimit të Performancës për Agjencitë në Kuadër të Administratës Shtetërore i qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=73509>

⁹ Për më shumë shih Planin Vjetor të Performances të AIP, i qasshëm në: <https://aip.rks-gov.net/download/plani-vjetor-i-performances-2024/?epdmdl=4086&refresh=65eebc85877021710144645>

edhe Monitorimin e zbatimit të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, si dhe garantimin e së drejtës për qasje në dokumente publike. Madje është e pakuptimtë dhe paradoksale që i njëjti institucion obligimet e saj ligjore ti prioritetizoj si objektiva në kuadër të Planit të saj të Performancës duke mos përcaktuar objektiva të qarta, aktivitete të matshme dhe reale të cilat ndihmojnë në funksionalizimin dhe progresin e e transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve publike. Pra, INPO vlerëson së në Planin e Performancës nuk janë dhënë informacione se çfarë aktiviteteve apo veprimesh SMART do të ndërmerren AIP për të përmbushur këtë objektiv. Në mungesë të këtyre të dhënave është vështirë e matshme përforma e AIP sa i përket kësaj shtylle.

Një objektiv tjetër që është vendosur në kuadër të këtij plani është edhe "*Organizimi i fushatave informuese për realizimin e së drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale dhe qasjes në dokumente publike*".¹⁰ INPO konsideron se organizimi i fushatave informuese është një hap pozitiv që do të shërbejë në edukimin proaktiv të institucioneve gjegjëse për të mos kufizuar qasjen në informacion, megjithatë as ky objektiv nuk ka informata se si do të realizohet apo cilat do të jenë produktet e tij.

Një plan i mirë i performancës bazuar në objektiva SMART, siç u tha më lartë, do të mundësojë edhe vlerësimin më objektiv të punës vjetore të AIP dhe hartimit të tij. Ligji Nr. 06/L -113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, obligon AIP-in që çdo vit, deri më datën 31 mars të vitit pasardhës, të prezantojë raportin e saj vjetor të performancës në një dëgjim publik me shoqërinë civile dhe publikun e gjerë. AIP, nuk e ka zbatuar një obligim të tillë ligjor dhe as nuk ka publikuar raportin vjetor të punës për vitin 2023, siç e obligon neni 44 i po këtij ligji.

Por, cila është fuqia dhe rëndësia e AIP në realizimin e tërësishëm të së drejtës për qasje në dokumente publike?

Mandati i AIP është i deleguar në atë formë që si agjenci në vete ngërdhen një numër të madh të kompetencave sa i përket zbatimit të LQDP, madje fuqia e saj është ekskluzive sa i përket detyrimit të palës për përmbushjen e kësaj të drejte sipas nenit 20 të ligjit. Tutje, përveç këtyre dispozitave ligjore të cilat i japin të drejta mbikëqyrëse agjencisë, i njëjti institucion ka kompetencë për ndërmarrjen dhe shqiptimin e masave të tjera të parapara me këtë ligj, saktësisht instrumenti i gjobës ndaj kufizimit të qasjes në dokumente publike është instrument i fuqishëm dhe goditës për të ndëshkuar institucionet të cilat kufizojnë qasjen në dokumente publike pa justifikim ligjor.

INPO gjatë praktikave të saj të kaluara, ka vërejtur që përkundër që ligji rregullon decidivisht çështjet e dokumenteve publike, AIP nuk shfryëzon fuqinë e tij të plotë institucionale duke mos implementuar LQDP ashtu siç është edhe qëllimi i tij, madje ky institucion *nuk trajton* ankesat brenda afatit 30 ditore të ligjit. Ky problem rezulton të jetë për shkak të mungesës së kapaciteteve

¹⁰ Për më shumë shih Planin Vjetor të Përformancës të AIP, i qasshëm në: <https://aip.rks-gov.net/download/plani-vjetor-i-performances-2024/?wpdmdl=4086&refresh=65eebc85877021710144645>

humane, duke marrë për bazë që ky institucion buxhetin e saj e ka shumë të ulët në raport me punën të cilën supozohet ta kryej. Një gjë të tillë është kritikuar edhe nga Raporti për Vendin i Komisionit Evropian.¹¹

Fuqia institucionale e (pa) shfrytëzuar nga AIP, dëshmohej qartazi me ankesën e parashtruar nga INPO ndaj Komunës së Gjilanit më 12.09.2022 për kufizim të qasjes në dokumente publike. Për këtë rast, AIP-it i janë dashur plotë njëqind e shtatëdhjet e pesë (175) ditë të vendos lidhur me këtë çështje deri në marrjen e vendimit final, respektivisht shqiptimin e gjobës. Shqiptimi i gjobës nga AIP për Komunën e Gjilanit, ka prodhuar një mobilizim të Komunës së Gjilanit për ofrimin e të gjithë dokumentacionit të kërkuar, madje të njëjtit janë përgjigjur edhe në një kërkesë tjetër paralele për qasje në dokumente publike, objekt i së cilës kanë qenë çështje të tjera të adresuara në po këtë komunë. Kjo dëshmon se fuqia institucionale e AIP mund të ketë efekt detyrues për palën në rast të kufizimit të qasjes në dokumente publike, por e njëjta rrallë e pak shfrytëzohet. Ndërsa, në kontekstin e rasteve kur shfrytëzohet, efektet pozitive janë të pashmangshme.

Instrumenti i gjobës dhe shqyrtimi i ankesave brenda afatit ligjor do të bënte institucione më të përgjegjshme dhe llogaridhënëse në raport me një të drejtë kushtetuese dhe ligjore. Mirëpo, legjislacioni është i mangët sa i përket shqiptimit të gjobes si dhe ofrimin e qasjes.

Pse?

Sipas LQDP edhe në rast të shqiptimit të gjobës, e njëjta nuk obligon institucionin që të ofroj qasje në dokumente publike, apo dokumentet/informatat të cilat kanë qenë objekt i kërkesës. Kësisoj, medoemos nevojitet plotësim/ndryshimi i LQDP që edhe në rast të shqiptimit të gjobës, qasja në dokumente publike të konsiderohet obligative për palën.

3.1. Korniza ligjore vs praktika

E drejta e qasjes në informacion dhe në dokumente publike është elementi themelor i transparencës dhe ofron mundësinë e luftimit të korrupsionit përmes monitorimit të aktiviteteve që janë me interes publik.. Rëndësia e qasjes në dokumente publike çdo dite e më shumë është duke u bërë evidente edhe në nivel global. Në Bashkimin Evropian e drejta e qasjes në dokumente garantohet nga Rregullorja Nr.1049/2001 e datës 30 Maj 2001 me Qasjen e Publikut në Dokumente të Parlamentit, Këshillit dhe Komisionit Evropian.¹²

Hapja e informatave ua mundëson qytetarëve të marrin pjesë për së afërmi në procese vendimmarrëse dhe garanton që administrata të gëzojë legjitimitet më të madh dhe të jetë më efektive dhe më e përgjegjshme ndaj qytetarëve në një sistem demokratik. Hapja njëherit kontribuon edhe në forcimin e parimeve të demokracisë dhe respektimit të të drejtave themelore

¹¹ Për më shumë, shih Raportin për Vendin, i qasshëm në <https://integrimievropian.rks-gov.net/raporti-per-kosoven-2023/>

¹² Për më shumë shih Rregulloren e PE, e qasshme në: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/en/TXT/?uri=CELEX%3A32001R1049>

sikurse përcaktohet me nenin 6 të traktatit të BE-së dhe në Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian.¹³

Korniza ligjore që e regullon qasjen në dokumente publike në Kosovë, konsiderohet që i plotëson standardet ndërkombëtare mirëpo në praktikë zbatimi i plotë i saj është sfiduese. Ndërsa, në Republikën e Kosovës kjo e drejtë përveç Kushtetutës, rregullohet edhe me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike dhe legjislacionin përkatës sekondar i njohur si Rregullore nr. 02/2022 për procedurën e brendshme të shqyrtimit të ankesave për qasje në dokumente publike. Tutje, AIP në kuadër të kompetencave dhe mandatit të saj ka miratur edhe një numër të udhëzuesve dhe broshurave informative se si të veprohet në raport me jetësimin e qasjes në dokumente publike.¹⁴

Qëllimi i Ligjit për Qasje në Dokumente publike garanton të drejtën e secilit person, pa diskriminim mbi çfarëdo baze, për të pasur qasje në dokumente publike, të prodhuara, pranuar, mbajtura apo kontrolluara nga institucionet publike, si dhe të drejtën për ripërdorimin e dokumenteve të sektorit publik.¹⁵

Së fundi, raporti i progresit për Kosovën për vitin 2023 e ka vlerësuar se disponueshmëria dhe sigurimi i informacionit dhe dokumenteve nga institucionet publike është sfiduese. Raporti po ashtu thekson se sistemi aktual për ofrimin e qasjes në këto informacione dhe dokumente nuk është duke funksionuar mirë dhe se AIP ka një buxhet dhe burime të kufizuara njerëzore. Fakti i mungesës së kapaciteteve humane sigurisht që ndikon në efikasitetin dhe efektivitetin e punës së AIP, mirëpo bazuar në praktikë INPO ka ngritur si shqetësim neglizhencën e AIP në trajtimin e ankesave apo zgjedhjen e tyre brenda afateve të përcaktuara me ligj. Për më tepër, ky nuk është i vetmi shqetësim i ngritur sepse AIP edhe në rast të zgjidhjes apo kompletimit të qasjes në dokumente publike, nuk merr konfirmim nga të dy palët për pranimin/dorëzimin e dokumenteve të caktuara.

Sa i përket zbatimit të ligjit dhe praktikave lidhur me shqyrtimin administrativ të ankesës pranë AIP, INPO ka hasur në mangësi dhe njëkohësisht shkëlqej të legjislacionit në fuqi, në këtë rast Ligjit për Qasje në Dokumente Publike dhe Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Mosrespektimi i afateve ligjore për zgjidhjen e ankesave brenda AIP mbetet një ndër sfidat kryesore të AIP. Të gjeturat e kësaj analize tregojnë se mesatarja e zgjidhjes së një anese nga AIP është dyzet e tetë (48) ditë,¹⁶ ani pse sipas LQDP afati për zgjidhjen e tyre është 30 ditë.¹⁷

¹³ Për më shumë shih Rregulloren e PE, e qasshme në: <https://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2001:I45:0043:0048:EN:PDF>

¹⁴ Për më shumë shih Udhëzuesit rreth Qasjes në Dokumente Publike, qasshëm në: <https://aip.rks-gov.net/qasja-ne-dokumente-publike/qasja-ne-dokumente-publike/>

¹⁵ Për më shumë shih Ligjin Nr.06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, i qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=20505>

¹⁶ **Shënim:** Mesatarja e zgjidhjes së ankesave në Agjencinë për Informim dhe Privatësi është kalkuluar përmes ankesave të INPO-s, të paraqitura në këtë institucion.

¹⁷ Për më shumë, shih nenin 20 i LQDP, i qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=20505>

Ndërsa, për të siguruar transparencë të plotë korniza ligjore specifikon qartë se të gjitha institucionet duhet të raportojnë pranë AIP sa i përket numrit të kërkesave për qasje në dokumente publike, e që në praktikë ndodhë krejtësisht ndryshe. INPO ka identifikuar institucionet të cilat nuk kanë raportuar pranë AIP rreth nivelit të zbatimit të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike siç janë: Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore, Agjencia Kadastrale e Kosovës, Agjencioni i Kosovës për Forenzikë, Agjencia e Kosovës për Akreditim, Instituti i Historisë, Shërbimi Sprovues, Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve, Komuna e Mamushës, Komuna e Shtërpcës, Komuna e Leposaviçit, Komuna e Zubin Potokut. Mosraportimi apo edhe raporti jo i saktë ngërthen në vete një papërgjegjshmëri institucionale, përtej kësaj paraqet edhe publikim jo real të të dhënave statistikore nga ana e agjencisë në raportet e saja vjetore për shkak të mungesës së tyre rreth nivelit të zbatimit të qasjes në dokumente publike.

Përderisa qasja në dokumente publike ende nuk ka arritur në nivelin e duhur të zbatueshmërisë, obligimi kryesor i qeverisë është të siguroj implementim të plotë të ligjit duke prioritetizuar atë dhe duke bërë monitorimin sistematik të performancës së institucioneve shtetërore karshi përmbushjes së këtij obligimi ligjor, meqë e njëjta parashihet edhe në Strategjinë e Reformës së Administratës Publike 2022-2027. INPO vlerëson se përforsimi i rolit të AIP si autoriteti kryesor ka një rëndësi jetike në promovimin e mbrojtjes së të dhënave personale dhe qasjen në dokumente publike që do të ndihmonte në përmirësimin e rritjes së performancës së punës të këtij institucioni duke lehtësuar edhe përmbushjen e kërkesave të qytetarëve në marrjen e informacionit apo dokumentacionit të caktuar publik që mbahen nga autoritetet publike.

4. Pasqyrë e përgjithshme statistikore e ankesave të paraqitura dhe të trajtuara nga AIP

Gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2023, në AIP janë parashtuar gjithsej 532 ankesa kundër kufizimit të qasjes në dokumente publike. Nga 532 ankesa AIP ka arritur që të shqyrtoj 415 sosh, ndërsa në proces të shqyrtimit janë 117 ankesa.¹⁸ Në këtë rast, mesatarja e zgjidhjes së ankesave është 78%. Në AIP janë gjithsej tre (3) zyrtarë përgjegjës për shqyrtimin e ankesave, që është një numër i vogël në krahasim me fondin e ankesave të depunuara gjatë vitit 2023, e që po ashtu trendi tregon për rritje të tyre në vitin 2024. Mesatarisht 117 ankesa janë trajtuar nga secili nga këta tre (3) zyrtarë gjatë vitit.

Të pranuar	Të zgjidhura	Në shqyrtim
532	415	117

Tabela 1: Totali ankesave në AIP.

¹⁸ **Burimi:** Kërkesë për qasje në informacion në Agjencinë për Informim dhe Privatësi

Tutje, 359 ankesa kanë rezultuar me vendime në favor të palës, apo është konfirmuar e drejta për qasje e palës së ankuar, ndërkaq 45 ankesa të tjera janë refuzuar plotësisht. Shprehur në përqindje rreth 89% e ankesave janë të bazuara dhe përfundojnë me vendime detyruese ndaj institucioneve për të ofruar qasje në dokumente dhe informata publike.

“89% e ankesave të parashtuara në AIP janë të bazuara dhe përfundojnë me vendime detyruese ndaj institucioneve për ofrim të qasjes në dokumente publike”.

Të pranuar	Të zgjidhura në favor të palës	Të refuzuara
532	359	45


Tabela 2. Totali i ankesave të zgjidhura në favor të palës dhe refuzimi i tyre.

Në anën tjetër, nga 415 ankesat e zgjidhura AIP ka shqiptuar në total 14 gjoba ndaj institucioneve si mekanizëm për shqyrtimin e tyre, me vlerë totale 47,000.00 euro. Në këtë situatë, institucioni më i gjobitur është Komuna e Fushë Kosovës me dhjetë (10) gjoba, ndërsa, Komuna e Gjilanit, Komuna e Shtërpçës, UP "Hasan Prishtina" dhe MMPHI-së me nga një (1) gjobë. Kjo situatë nënkupton se të gjitha insitucionet e lartëcekura, në kundërshtim me parimet legislative kanë refuzuara qasjen në dokumente publike.

INPO ka vërejtur se në nga viti në vit në AIP kemi një rritje të rëndësishme të ankesave. Në tri (3) vitet e fundit (gjashtë mujori i dytë i vitit 2021, 2022 dhe 2023) janë parashtuar 1,092 ankesa pranë këtij institucioni.¹⁹ Nëse krahasojmë rritjen e ankesave në mes të vitit 2022 dhe 2023, atëherë shprehur në përqindje, në vitin 2023 kemi një rritje prej 26.3% të ankesave të parashtuara.

“Vlera totale e gjobave të shqiptuara nga AIP kufizimit të qasjes në dokumente publike gjatë vitit 2023 është 47,000.00 EUR”.

¹⁹ Për më shumë shih Raportet vjetore të Agjencisë për Informim dhe Privatësi, 2021 i qasshëm në: <https://aip.rks-gov.net/download/raporti-vjetor-i-punes-per-vitin-2021/?wpdmdl=2476&refresh=65f597302c81b1710593840> dhe 2022 i qasshëm në: <https://aip.rks-gov.net/download/raporti-vjetor-i-punes-per-vitin-2021-2/?wpdmdl=3442&refresh=65f592a23fdb51710592674>



Diagrami 1. Trendi i rritjes së ankesave në AIP

Ky trend i rritjes së ankesave vë në pah së paku tre (3) faktorë ndikues. Njëri faktor flet për një mbyllje të institucioneve publike ndaj të cilave është ushtruar kërkesë për qasje në dokumente publike dhe të cilat qoftë me heshtje, qoftë me veprime administrative kanë refuzuar qasjen, si dhe dy faktorët e tjerë siç janë ngritja e vetëdijes së palëve për të ushtruar mjetet juridike në dispozicion kundër kufizimit të qasjes për shkak edhe të funksionalizimit të plotë të AIP me rastin e zgjedhjes së Komisioneres për Informim dhe Privatësi.

4.1. Cilësia dhe konsistenca e vendimeve të AIP

Procedura e shqyrtimit të ankesave në rast të refuzimit të tërësishëm apo të pjesshëm të kërkesës për qasje në dokumente publike, përveç legjislacionit primar trajtohet edhe me anë të legjislacionit sekondar, respektivisht me Rregullorën nr. 02/2022 për procedurën e brendshme të shqyrtimit të ankesave për qasje në dokumente publike. Përmes Departamentit për Qasje në Dokumente Publike në kuadër të AIP, ligjërisht procedura për shqyrtimin e ankesave do të duhej të përfundonte brenda 30 ditëve, por në praktikë rezultojnë të ketë zvarritje në shqyrtimin e tyre.

Vetëm INPO, përgjatë vitit 2023 ka parashtruar njëqind e shtatëdhjetë (170) kërkesa për qasje në dokumente publike në institucione të ndryshme publike lokale dhe qendrore. Në njëqind e tridhjetë e tetë (138) raste INPO ka realizuar të drejtën për qasje ndërsa, për tridhjetë e dy (32) raste të tjera INPO ka parashtruar ankesë në AIP për shkak të kufizimit të qasjes.²⁰ Agjencia si institucion mbikqyrës dhe bartës për realizimin e qasjes në dokumente publike, ankesat e INPO-s, ka zgjidhur në afate të ndryshme kohore dhe asnjëherë brenda afatit ligjor.²¹ Madje, zgjidhja e ankesës konsiston edhe në interpretim jo të duhur të llogaritjes së afatit të paraparë me ligji për zgjidhjen e tyre nga AIP.

²⁰ Për më shumë, shih të dhënat e INPO-s rreth qasjes në dokumente publike, të qasshme në:

<https://www.facebook.com/photo.php?fbid=769542075215135&set=pb.100064780480340.-2207520000&type=3>

²¹ Për më shumë shih nenin 10, paragrafi 7, i qasshëm në: <https://aip.rks-gov.net/download/rregullore-nr-02-2022-per-proceduren-e-brendshme-te-shqyrtimit-te-ankesave-per-qasje-ne-dokumente-publike/?wpdmdl=1785&refresh=65e720ba505e41709646010>

Për ankesën me numër të protokollit 528 të ushtruar kundër Komunës së Kaçanikut për shkak të refuzimit të qasjes në dokumente publike, AIP ka përfunduar procedurën e shqyrtimit administrativ pa marrë miratimin e palës ankuese, në këtë rast INPO me arsyetimin se pala ankuese ka heshtur në përgjigje ndaj AIP në afat ligjor brenda tre (3) ditëve, i cili përcaktohet me rregullore të brendshme të AIP.

INPO për këtë kërkesë ka ndërmarrur veprime ligjore, respektivisht ankesë në Agjencinë për Informim dhe Privatësi, kundër Komunës së Kaçanikut për kufizim të qasjes në dokumente publike me datë 31.08.2023. Përkundër rikujtimit të vazhdueshëm të AIP në lidhje me këtë ankesë, të njëjtit veprimin e parë konform kompetencave ligjore kanë ndërmarrë me datë 02.06.2023 apo dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë (276) ditë pas parashtrimit të ankesës. Komuna e Kaçanikut pas pranimit të Vendimit me nr. A-528 të datës 02.06.2023, i cili obligon institucionin që brenda shtatë (7) ditëve të përgjigjet ndaj kërkesës për qasje në dokumente publike, me 08.06.2023, në adresë të INPO-s ka përcjellur disa dokumente të cilat ndërliidhen me kërkesën për qasje në dokumente. Në po të njëjtën AIP përmes postës elektronike është shprehur se: *“Në vijim të ofrimit të dokumenteve të njëpasnjëshme nga Komuna e Kaçanikut, sipas ankesës tënde nr.528, të lutem të deklaroresh nëse konsideron që është arritur qëllimi i synuar përmes kërkesës fillestare të paraqitur pranë këtij institucioni publik, në mënyrë që AIP të mund të mbyllë shqyrtimin e ankesës në fjalë!”*. Sipas Rregullores nr. 02/2022 për procedurën e brendshme të shqyrtimit të ankesave për qasje në dokumente publike, përkatësisht nenit 10, paragrafi 8: *“pala ankuese obligohet që brenda tri ditëve t’ia konfirmojë Agjencisë pranimin e këtij njoftimi apo të dokumenteve të ofruara sipas kërkesës së tij/saj.”*²²INPO brenda afateve ligjore, përkatësisht me datë 12.06.2023 në drejtim të Komunës së Kaçanikut ka kërkuar pjesën e mbetur të dokumentacionit për të kompletuar në tërësi qasjen në dokumente publike, mirëpo AIP në të njëjtën datë, respektivisht 12.06.2023, nxjerrë vendim për përfundimin e shqyrtimit të procedurës administrative me arsyetimin se INPO ka heshtur sa i përket konfirmimit të dokumenteve brenda afateve ligjore. Kjo situatë përbën shkelje nga Agjencia për Informim dhe Privatësi të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike dhe Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe e njëjta konsiston në interpretim të gabuar në kalkulim të afateve.

Sipas LPPA, përkatësisht nenit 81, paragrafi 4, *“Kur dita e fundit e një afati bie të shtunën, të dielën apo një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen menjëherë pas saj”*. Në këtë rast, sipas shkresës së AIP dita e fundit për konfirmim i bije të jetë data 10 qeshor 2023, pra ditë e shtunë dhe afati mbaron në ditën e parë të punës që vjen menjëherë pas saj, në rastin e INPO-s, dita e hënë, po atë ditë kur INPO ka kthyer përgjigje tek Komuna e Kaçanikut.

Tutje, INPO ka informuar AIP për shkeljet të cilat ka shkaktuar me nxjerrjen e vendimit si dhe interpretimin e gabuar sa i përket kalkulimit të afateve ligjore, kështu duke kërkuar rishqyrtim të

²² Për më shumë shih nenin 10, paragrafi 8, i qasshëm në: <https://aip.rks-gov.net/download/rregullore-nr-02-2022-per-proceduren-e-brendshme-te-shqyrtimit-te-ankesave-per-qasje-ne-dokumente-publike/?wpdmdl=1785&refresh=65e720ba505e41709646010>

vendimit me nr. A-528, mirëpo të njëjtit janë përgjigjur se: “Meqenëse procedurat e ndjekura nga AIP janë në përputhje me ligjin përkatës dhe rregulloren e brendshme të AIP-së që rregullon procedurat e shqyrtimit të një ankese, vendimi përmbyllës nuk mund të shfuqizohet.” Madje, të njëjtit kanë rekomanduar që për këtë çështje të paraqitet kërkesë e re për qasje në dokumente publike për pikat e papërbushura. Pra, për AIP më e arsyeshme është përfundimi i procedurës administrative pa përbushjen e kërkesës për qasje në dokumente publike dhe ridërgimi edhe njëherë i saj për të njëjtën çështje, se sa zgjidhja dhe përbushja e saj sipas nenit 20 të po këtij ligji.

Agjencia sikurse është cekur edhe më lartë në misionin e saj e ka edhe shqiptimin e gjobave si akt përfundimtar, mirëpo marrja e vendimeve për ankesat e parashtruara (shqiptimi i gjobës) nuk ka arritur të ketë vëmendjen e duhur dhe si rezultat i kësaj institucionet gjegjëse nuk kanë krijuar qasje përmirësuese ndaj qytetarëve. Duke pasur parasysh trendin e rritjes së ankesave, ndërgegjësimi i vet institucioneve publike në raport me njohjen e së drejtës për qasje në dokumente publike nuk është duke treguar rezultate pozitive. Në këtë drejtim AIP përkitazi me rekomandimin të rrisë efikasitetin e trajtimit të lëndëve brenda afateve ligjore të shqiptojë edhe gjoba kurdoherë që përfundojnë afatet ligjore dhe insitucioni nuk bashkëpunon për të ofruar qasje.

Tutje, mungesa e konsistencës në shqyrtimin e ankesave nga ana e Agjencisë për Informim dhe Privatësi është një dukuri tjetër negative që INPO e vlerëson shqetësuese, e cila ndikon drejtëpërdrejtë në mospërbushjen e objektivave për të cilat është i thirrur ky institucion. Shqyrtimi i rasteve me standarde të dyfishta shkakton një sfidë të pashmangshme për institucionet publike, madje njëjtë ka vepruar edhe AIP. Zgjidhja e ankesave me standarde të dyfishta reflektohet përmes zgjedhjes së dy ankesave të parashtruara nga INPO në AIP, kundër Komunës së Gjilanit, e cila i kishte kufizuar INPO-s qasjen në dokumente publike, respektivisht informatave dhe dokumenteve rreth aktiviteve të prokurimit publik.

4.1.1. INPO vs Komuna e Gjilanit vs AIP

Qasja në dokumente publike gjithnjë lejohet, nëse dokumenti publik i kërkuar ka të bëjë me shpenzimet e parasë publike, kështu përcakton ligji aktual i qasjes në dokumente publike. Andaj, edhe në këtë rast objekt i kërkesave në Komunën e Gjilanit kanë qenë dokumentet publike, për çështjet që i’u referohen shpenzimit të parasë publike, respektivisht ato të prokurimit publik të cilat në parim do të duhej të ishin të publikuara në ueb faqen e komunës në fjalë dhe platformën e e-prokurimit. Kësisoj, të gjitha dokumentet të cilat janë të paqasshme në ueb faqe, shoqëria civile apo edhe të interesuarit e tjerë obligohen që ti sigurojnë përmes kërkesave për qasje në dokumente publike.

Në këtë rast, INPO me 18.08.2022 ka parashtruar ankesë në AIP kundër Komunës së Gjilanit, për shkak të kufizimit të qasjes në dokumente publike për një (1) aktivitet të prokurimit dhe dy (2) kontrata. Gjatë rrugës Komuna e Gjilanit ka refuzuar qasjen në dokumente publike, duke u arsyetuar se kontrata me titull “Rregullimi i infrastrukturës rrugore, trotualet, ndriçimi publik në Sos

fshatin në Zabel”, me numër të prokurimit 651-20-6280-5-2-1 është në fazën hetimore nga Policia e Kosovës

Pas njëqind e shtatëdhjetë e pesë (175) ditësh, pas shtjerrimit të procedurave ligjore, AIP ka gjobitur me 4,000Eur Komunën e Gjilanit për shkak të kufizimit të qasjes në dokumente publike, duke mos e pranuar si justifikimimin e komunës se aktiviteti i prokurimit për të cilin është kërkuar kontrata është nën hetime nga organet e ndjekjes. Vlen të theksohet se Komuna e Gjilanit, asnjëherë nuk ka nxjerrë vendim për refuzimin e qasjes, me arsyetimin përkatës, ashtu siç e obligon ligji.



Nr. Gj-556/2023
Datë: 06.03.2023

Në mbështetje të nenit 21, 26 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 20 të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, përkritazi me ankesën nr.556, të parashtruar më datën 12.09.2022 nga zsh. Leoreta Alija nga OJQ 'INPO', ndaj Komunës së Gjilanit, për kufizimin e qasjes ndaj kërkesës për qasje, të parashtruar më 18.08.2022. Agjencia për Informim dhe Privatësi nxjerr këtë:

V E N D I M

- Shqiptohet gjobë ndaj Komunës së Gjilanit për moszbatimin e vendimit Nr. A-556/2023 të datës 11.01.2023, në shumën prej 4,000.00 (katërmijë eurosh) për kufizimin e qasjes në dokumente publike.
- Obligohet Komuna e Gjilanit që shumën prej 4,000.00 (katërmijë eurosh) ta paguajë, në afat prej 30 ditësh, në xhironlogarinë e autoritetit kompetent për shqiptimin e gjobës nr. 100400070005127/ Banka Qendrore e Republikës së Kosovës.
- Vendimi hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas pranimit të vendimit.

Arsyetim

Në bazë të nenit 20, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, Agjencia ka pranuar një ankesë nga pala zsh. Leoreta Alija nga 'INPO', me nr. të protokollit 556, të datës 12.09.2022, të ushtruar ndaj Komunës së Gjilanit, për kufizim të qasjes në dokumentet e përmendura në pikën 2 të vendimit të datës 11 janar 2023.

Gjatë shqyrtimit të ankesës, Agjencia, përmes vendimit A-556/2023 të datës 11 janar 2023, në pajtim me nenin 20, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, ka obliguar Komunën e Gjilanit që t'i ofrojë palës dokumentet publike të mbetura si të paofruara.

Komuna e Gjilanit, me gjithë paralajmërimin e AIP-së që kishte vetëm shtatë ditë afat për ta jetësuar kërkesën e palës ankuese, duke i ofruar dokumentet e kërkuara nga pala, nuk ka zbatuar vendimi e Agjencisë për Informim dhe Privatësi, e cila, më 14 shkurt 2023 i ka dërguar një njoftim për shqiptimin e gjobës administrative.

Institucioni publik, më 15 shkurt 2023 i ka dërguar AIP-së një njoftim, brenda të cilit e ka mbajtur të njoftuar edhe palën ankuese, e cila do të mund të shkonte në Komunën e Gjilanit (në zyrën e njësisë përgjegjëse) të nesërmen në orën 13:00. Gatisshmëria e shprehur e institucionit publik për të ofruar qasje ndaj palës në një format tjetër, nuk e zhveshë atë nga obligimi ligjor për ta respektuar formatin e përzgjedhur nga pala në shkresën e 2 shtatorit 2022. Obligimi i institucionit publik për ta respektuar formatin e përzgjedhur nga pala buron nga paragrafi 1 dhe 2 i nenit 14 të Ligjit Nr.06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike.

Pavarësisht dërgimit të njoftimit për shqiptimin e gjobës administrative, të datës 14 shkurt 2023, institucioni publik ka ofruar vetëm një dokument të lëshuar nga njëra e hetuesisë në Policinë e Kosovës, të datës 30 maj 2021, përmes të cilit janë kërkuar dokumente lidhur me njërin nga kontratat objekt kërkesë, por që nuk përkojnë me dokumentet specifike të kërkuara nga pala ankuese, të cilat kishin mbetur të paofruara nga institucioni publik.

Agjencia për Informim dhe Privatësi, duke vënë re gatishmëri serioze të këtij institucioni publik për ta jetësuar në plotni të drejtën e palës për t'u informuar përmes dokumenteve të kërkuara, të cilat lidhen me shpenzimin e parasë publike, është detyruar të vazhdojë me hapin e radhës të shqyrtimit të kësaj ankesë, duke nxjerrë Vendimin Nr. Gj-556/2023, përmes të cilit i shqiptohet gjobë institucionit publik në fjalë, shumën e së cilit ekzekutimin e këtij vendimi.

Siç është përshkruar në arsyetimin e lartcukur dhe bazuar në nenin 20, nënparagrafi 4 të Ligjit për Qasje e në Dokumente Publike, Agjencia ka marrë vendimin e paraqitur në dispozitiv.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të paraqesë padi për kundërshtim në gjykatën kompetente për çështje administrative brenda 30 (tridhjetë) ditësh, nga data në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.



Vendimi i dërgohet:

- Z. Alban Hyseni, Zyrtar Përgjegjës, Komuna e Gjilanit
- Zsh. Leoreta Alija, Ankuese, OJQ 'INPO'

Figura 1. Vendimi Gj-556/2023, nxjerruar nga Agjencia për Informim dhe Privatësi, ndaj Komunes së Gjilanit

Ndryshe nga ankesa me numer të protokollit 556 AIP ka vepruar me ankesën me numër të protokollit 810 kundër të njëjtës komunë të parashtruar më 22.11.2023 nga INPO për shkak të refuzimit të qasjes në dokumente publike, ku i ka dhënë të drejtë komunës së Gjilanit në mos ofrimin e qasjes sipas arsyetimit të dhënë.

Komuna e Gjilanit ka refuzuar qasjen në dokumente publike për shkak që kontrata e kërkuar me titull “Ndërtimi i tregut të Gjelbërt në Komunën e Gjilanit” me numër 651-21-1775-5-1-5, është në fazë hetimore nga ana e Policisë së Kosovës. As për këtë refuzim komuna nuk ka nxjerrur vendim

për refuzim së bashku me arsyetimin ligjor. INPO edhe në këtë rast ka parashtruar ankesë në AIP kundër refuzimit të qasjes në kontratën respektive. Vlen të përmendet që kontrata sipas legjislacionit të aplikueshëm për prokurim publik duhet të publikohet në momentin e nënshkrimit të saj. Pra, është e pakuptimtë që një dokument i cili duhet të publikohet në momentin kur i njëjti prodhohet, të kufizohet pastaj me arsye të procese të tjera.

Pas më shumë se një (1) muaji, nga ankesa e INPO-s, më 28.12.2023 AIP vendos që të mbështesë Komunën e Gjilanit, rreth arsyetimit për kufizimin e qasjes, respektivisht, justifikimin se qasja në dokumente refuzohet për shkak se lënda është nën hetime. Por, AIP nuk kishte kërkuar nga komuna që rreth arsyeshmërisë së kufizimit të qasjes të bëhet edhe testi i dëmit dhe i interesit publik si dhe të nxirret vendimi për refuzim sipas obligimeve ligjore. Pas kundërshtimeve të INPO-s gjatë zhvillimit të procedurës së shqyrtimit në AIP, pas rreth dy (2) muajve, AIP kërkon nga Komuna e Gjilanit që brenda tre (3) ditëve, të informojë të njëjtën nëse lënda është akoma nën hetime. Mirëpo, komuna nuk i përgjigjet AIP-it rreth kësaj çështje. Tutje, AIP më 29.03.2024, apo pas më shumë se dy muajve aprovon si të bazuar ankesën e INPO-s me numër protokollit 810, ku e obligon komunën e Gjilanit që brenda 7 ditëve të ofrojë qasje të plotë në kërkesën e INPO-s. Shtatë (7) ditë pas këtij vendimi INPO informon AIP-n se vendimi i saj nuk është përmbuar nga komuna e Gjilanit dhe se INPO nuk ka pranuar qasje në dokumentet e kërkuara. AIP më 18.04.2024 e njofton Komunën e Gjilanit se do të gjobitet në rast se brenda shtatë (7) ditëve shtesë nuk ofron qasje. Brenda kësaj periudhë shtatë (7) ditore komuna e Gjilanit, e njofton AIP-in se lënda është akoma nën hetime. AIP më të marrë këtë informacion menjëherë më 23.04.2024 nxjerrë vendim për përfundimin e procedurës administrative, respektivisht duke e lënë INPO-n pa realizuar të drejtën e saj për qasje.

INPO vlerëson se përfundimi i procedurës administrative nga ana e AIP, duke mos u bazuar në asnjë argument të qëndrueshëm dhe ligjor rreth arsyeshmërisë dhe bazës për refuzimin e kërkesës për qasje, por vetëm përmes një konfirmimi nga ana e komunës, e cila nuk është autoritet për të vendosur se cilat nga dokumentet apo informacionet mund të çënojnë integritetin e hetimeve, siç thuhet në nenin 17 të ligjit për qasje, është keqpërdorim i detyrës zyrtare dhe krijon precedent të rrezikshëm dhe mundëson përdorimin e kësaj arsye të “paarsye” nga insitucionet të cilat nuk dëshirojnë të ofrojnë qasje publikut. AIP para se të mbyllë lëndën do të duhej që të marrë një konfirmim nga Prokurori i Shtetit, i ngarkuar me rastin për të verifikuar nëse vërtetë dokumentet e kërkuara nga INPO çënojnë integritetin e hetimeve.

Kësisoj, përpos komunës së Gjilanit e cila i ka kufizuar INPO-s qasje në dokumente edhe AIP pas zvarritjes së lëndës në më shumë se 153 ditë, mbështetë dhe arsyeton veprimet e komunës. Andaj, INPO thekson se edhe në ankesën me numër 556 ka qenë pothuajse situatë dhe procedurë identike me komunën, me ç’rast AIP ka obliguar komunën që të ofrojë qasje, ndërkaq në ankesën 810 me të njëjtat karakteristika vendos në favor të kufizimit të qasjes, me ç’rast me të drejtë këto raste mund të konsiderohen si vendime jo-konsistente të AIP-it.

5. Rasti i Flutura Kusari “sfidë” për AIP-in

Ndryshe nga vitet e kaluara dhe ushtrimet të funksionit të përditshëm në raport me ankesat e parashtuara, AIP në kuadër të mandatit të saj në vitin 2022 është ballafaquar edhe me kërkesë për de-klasifikim të dokumente publike, rast i cili krijon mundësi që AIP të dëshmojë pavarësinë e plotë institucionale për mbikqyrjen dhe zbatimin e qasjes në dokumente publike. Në këtë rast, “paanshmërinë” e saj. INPO konsideron se ky rast konsiston të jetë “sfidë” për AIP-in.

Kërkesa për de-klasifikim të dokumente publike vjen si pasojë e vendimit nr. 12/2022 të marrë nga ish-drejtori i Thesarit të Kosovës, Ahmet Ismajli, ku kishte klasifikuar si konfidenciale të gjitha informacionet të cilat ndërlidheshin me “Fondin e Sigurisë”. Asokohe, kryeministri i Kosovës me anë të vendimit Nr.231 të datës 01.03.2022, kishte autorizuar Ministrin e Financave, Punës dhe Transfereve për hapjen e llogarisë së “Fondit të Sigurisë” përmes së cilës do të bëhej pranimi i donacionave nga qytetarët dhe të njëjtat do të dedikoheshin për fushën e mbrojtjes dhe sigurisë shtetërore, por çuditërishtë shumica e mbledhur nuk u bë e ditur asnjëherë nga qeveria.

Juristia e medias/aktiviste Flutura Kusari, me datë 8 qeshor 2022 kishte parashtuar kërkesë për de-klasifikim të dokumenteve pranë AIP-it. Që nga ai moment, AIP ka ndërmarrë një sërë veprimesh në drejtim të trajtimit të kërkesës, për të cilën edhe pse kanë kaluar më shumë se njëzet e një (21) muaj nga protokollimi i saj, akoma nuk ka një vendim final për të, apo një epilog për të ditur nëse informatat e klasifikuara nga qeveria janë konfidenciale apo duhet të jenë të qasshme për publikun.

Bazuar në korrespondencën e zhvilluar në mes të AIP-it dhe Thesarit të Kosovës, INPO ka gjetur se AIP-i ka vlerësuar se “vendimi për klasifikimin e informatave nuk tregon se cilat nga bazat për klasifikim është aplikuar në rastin konkret”.²³ Në publikimin e këtij raporti AIP-i, siç u tha më lartë, nuk ka nxjerrur asnjë vendim përfundimtarë, pavarësisht se të gjitha afatet e lejshme ligjore kanë kaluar, për të vendosur nëse informacionet rreth shumës së “Fondit të Sigurisë” duhet të jenë publike dhe se të njëjtat institucioni që i ka klasifikuar duhet t’i deklasifikoj apo se këto informacione realisht duhet të jenë të klasifikuara. Pra, mbajtja pezull e kësaj çështje pa epilog, cënon integritetin e AIP-it dhe arsyeshëm lë hapësirë për dyshime rreth pavarësisë së AIP-it në shqyrtimin e kërkesave apo ankesave të palëve kur kemi të bëjmë me çështje të tilla, ku të përfshirë në kufizimin e qasjes janë persona me autoritet të lartë qeverisës.

Duke parë zvarritjen e trajtimit të këtij rasti dhe kufizimit për qasje në informacion, lidhur me këtë çështje organizatat e shoqërisë civile, përkatësisht INPO, IKD, Lëvizja FOL dhe YIHR kanë reaguar publikisht duke kërkuar që Qeveria e Republikës së Kosovës të hap të dhënat sa i përket “Fondit të Sigurisë”, duke listuar një mori argumentesh ligjore që kanë të bëjnë me këtë çështje. Njëra ndër argumentet kryesore të këtij reagimi ishte se si mund të konsiderohet “konfidenciale” shumica e grumbulluar për “Fondin e Sigurisë”, kur të gjitha Ligjet për Ndarjet Buxhetore për

²³ Kërkesë për ofrimin e qasjes në informacion për shumën e mbledhur të Fondit të Sigurisë, bazuar në përgjigjen e datës 28.07.2022, Nr.protokolli 357, e datës 05.09.2022.

Buxhetin e Republikës së Kosovës ofrojnë të dhëna të detajuara mbi buxhetin e tërësishëm për Forcën e Sigurisë së Kosovës.²⁴ Madje, edhe AIP në korrespondencën e saj me Thesarin e Kosovës e ka konsideruar tërësisht paradoksale mbylljen e këtyre të dhënave, meqë Buxheti i Republikës së Kosovës, pasqyron të gjitha të dhënat mbi buxhetin dhe se të gjitha të dhënat janë të detajuara.

Duke marrë parasysh të gjitha ligjet në fuqi që i dedikohen transparencës dhe llogaridhënies dhe jo vetëm dhe gjithashtu praktikat ndërkombëtare, institucionet përgjegjëse kanë obligim të hapin të dhënat e tyre të cilat kanë të bëjnë me interesin publik. Kësisoj, INPO fton Qeverinë e Republikës së Kosovës, respektivisht Ministrinë e Financave, Punëve dhe Transfereve - Thesari i Kosovës, Ministrinë e Mbrojtës dhe Agjencinë për Informim dhe Privatësi që sa më shpejtë të ofrojnë zgjidhje sa i përket rastit që është adresuar nga Flutura Kusari dhe ka një rëndësi publike e cila njëherësisht “penguar” nga institucionet e Kosovës.

Mbyllja e të dhënave në këtë formë dhe mungesa e transparencës nuk i shërben as interesit qeveritarë e as qytetarëve të Republikës së Kosovës, të cilët kanë të drejtën e informimit mbi bazën e legjislacionit të cilat janë miratuar nga vet qeveria.

6. Ndikimi i INPO-s në ngritjen e transparencës dhe llogaridhënies

Mungesa e llogaridhënies efektive në institucionet shtetërore rezulton me pasoja siç janë administrimi joefikas, barrierat në vendimmarrje, shërbimet e dobëta, si dhe mungesa e mosbesimit në shërbimin publik. Meqenëse administrata publike është pengesa kryesore për të bërë përmirësime, konsolidimi i llogaridhënies dhe transparencës është i një rëndësie thelbësore.

INPO shumë vite me radhë është duke avokuar në forcimin e parimit të transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve publike, informimin e qytetarëve për të drejtat e tyre si dhe luftimin e korrupsionit, duke punuar në promovimin e vlerave të një shoqërie të hapur dhe demokratike. Kjo është dëshmuar edhe përmes publikimeve të ndryshme të INPO-s, referuar një numër të gjerë të fushave për një qeverisje të mirë dhe zhvillim demokratik.

Korniza ligjore për qasje në dokumente publike e rregullon qartë publikimin e dokumenteve, respektivisht çdo dokument i cili ndërlidhet me shpenzimin e paras publike duhet të publikohet. Në këtë rast, INPO ka hasur se (i) mospublikimi i dokumenteve, (ii) heshtja apo kufizimi i qasjes në dokumente publike si dhe (iii) trajtimi jo serioz i ankesave rezultojnë të jenë probleme endemike të cilat ndikojnë në një administratë publike jotransparente, joeficiente dhe joefikase në të gjitha nivelet e qeverisjes. Megjithatë, gjatë monitorimeve dhe hulumtimeve të ndryshme INPO ka hasur në një transparencë më të hapur në nivel lokal dukshëm më shumë sesa në atë qendror.

Kësisoj, përmisimi i transparencës dhe llogaridhënies në nivel lokal kanë qenë parimet bazë të INPO-s, madje INPO ka arritur të përmbush parimet e saj përmes tryezave, forumeve apo edhe konsultimeve, debateve publike dhe analizave të thukta për çështje që ndikojnë për një qeverisje

²⁴ Për më shumë shih reagimin e INPO-s në partneritet me IKD, Lëvizja FOL dhe YIHR, i qasshëm në <https://inpo-ks.org/ikd-inpo-fol-dhe-yihr-ks-qeveria-te-hap-te-dhenat-e-fondit-te-sigurise/>

të mirë. Në mesin e tyre është edhe publikimi sistematik i Raportit Vjetor për Qasje në Dokumente Publike për secilin vit nga institucionet në nivel qendror dhe lokal ku përfshihet numri i rasteve në të cilat institucioni publik ka lejuar qasjen, numri i rasteve në të cilat institucioni publik ka refuzuar qasjen në dokumente, si dhe arsyet e këtyre refuzimeve.

Sigurisht, që institucionet posedojnë shumë më shumë informata apo të dhëna që nuk i publikojnë ato në ueb faqet e tyre dhe kështu krijohet nevoja e ndjekjes së të drejtave ligjore për të fituar këtë të drejtë kushtetuese. Duke marrë për bazë numrin e lartë të kërkesave për qasje në dokumente publike të cilat parashtrohen në institucione publike, medoemos paraqiten edhe ankesa kurdo që këto kërkesa refuzohen. Në këtë rast, pas ankesave të INPO-s në AIP, ky institucion ka shqiptuar në total tre (3) gjoba ndaj tre (3) komunave në vlerë totale 11,000 EUR. Komunat e gjobitura janë ajo e Gjilanit, Shtërpces dhe Fushë Kosovës.²⁵

²⁵ Për më shumë shih infografikën e INPO-s rreth qasjes në dokumente publike, e qasshme në <https://inpo-ks.org/wp-content/uploads/2023/12/Infografika-e-qasjes-ne-dokumente-publike-INPO.pdf>

7. Konkluzione dhe Rekomandime

INPO vlerëson se legjislacioni në fuqi për qasje në dokumente publike nuk është duke u zbatuar në mënyrë efektive dhe rekomandon AIP të fuqizojë mekanizmat adekuat monitoruese për të siguruar zbatimin praktik të standardeve të qasshmërisë dhe legjislacionit përkatës, duke qenë se transparenca dhe llogaridhënia janë thelbësore për funksionimin e një shoqërie demokratike.

Mos publikimi proaktiv i dokumenteve publike dhe mos repektimi i kornizës ligjore për qasje në dokumente publike nga ana e insitucioneve publike ka bërë që të rritet numri i ankesave në AIP. Gjetjet e analizës tregojnë se ende nuk ka ndërgjegjësimit të mjaftueshëm sa i përket rëndësisë së lejimit në qasjes në informacion dhe se nevoja për përmirësimin e politikave në këtë drejtim është urgjente.

Në analizën e INPO-s, vërehet se mesatarja e zgjidhjes së ankesës në Agjencinë për Informim dhe Privatësi është dyzet e tetë (48) ditë. Megjithatë, kjo konsiston edhe në mungesë të burimeve njerëzore me të cilat ballafaqohet ky institucion dhe si pasojë ka efekt negativ në përmbushjen apo zbatimin e plotë të legjislacionit në fuqi. Kësisoj, INPO rekomandon që Qeveria e Republikës së Kosovës sa më parë të adresoj çeshtjen e mungesës së fondeve të mjaftueshme e cila e pamundëson funksionalizimin e plotë të AIP.

Tutje, për numrin e lartë të ankesave INPO vlerëson se ka një nivel më të lartë të vetëdijës së qytetarëve, mediave dhe shoqërisë civile sa i përket parashtrimin të ankesave në këtë institucion përkitazi me funksionalizimin e plotë të AIP me rastin e zgjidhjes së Komisioneres. Megjithatë vëmendje të duhur do të duhej ti kushtoj zgjidhjes së tyre. Andaj, INPO rekomandon që AIP të adresojë sfidat dhe problemet me kapacitetet e saj, në mënyrë që ankesat të të zgjidhen brenda afatit të përcaktuar ligjor.

Analiza gjeti se AIP në kuadër të Planit të Performancës ka vendosur objektiva monitorimi i së cilave është i vështirë, bazuar në atë se nuk janë të bazuara në indikatorë matës dhe referues. INPO i rekomandon AIP që në planin e saj të punës duhet të përmbajë objektiva konkrete, të zbatueshme dhe të kufizuara në kohë për monitorimin dhe vlerësimin e Planit të Performancës.

AIP nuk ka publikuar raportin e punës për vitin 2023 dhe as nuk ka mbajtur takim publik me shoqërinë civile për të prezantuar punën, sfidat dhe të arriturat gjatë vitit 2023.

AIP duhet të jetë konsistente në vendimet e saj dhe sigurohet se justifikimi i insitucioneve për refuzimin e qasjes në dokumente publike për shkak të cënimit të hetimeve, të jetë i bazuar në ligji dhe sipas autoritetit që ka në kompetencë për të kufizuar qasjen në dokumente që potencialisht çenojnë hetimet nga organet e ndjekjes. Në këto raste nuk duhet të shmanget edhe detyrimi për tu aplikuar edhe testi i dëmit dhe i interesit publik, kurdoherë që insitucioni nxjerrë vendim për refuzim sipas nenit 17 të ligjit për qasje në dokumente publike.

AIP-i të ushtrojë detyrat dhe kompetencat e saj ligjore pa dallim ndaj kërkesave apo paleve të përfshira në shqyrtimin e lëndëve, sikurse rasti i aktivistes Flutura Kusari, për deklasifikimin e informacioneve për Fondin e Sigurisë, dhe sa më parë të japë epilogun këtij procesi. Mungesa e vendosjes për një çështje kaq të thjeshtë në procedurë ngritë dyshimet rreth integritetit dhe pavarësisë institucionale të AIP-, në këtë rast të Komisioneres.


INPO nënvizon rëndësinë jetike që AIP duhet të marr në konsideratë vendosjen e sanksioneve për dështimin e paarsyeshëm të kërkesës për qasje në dokumente publike për t'u siguruar qytetarëve qasjen e plotë në informacion. Shqiptimi i gjobës duhet të aplikohet në mënyrë që institucionet të cilët refuzojnë qasjen në informata të ndërgjegjësohen.



Iniciativa për Progres (INPO) është organizatë joqeveritare dhe jofitimprurëse e themeluar ne vitin 2005 me qëllim që të përparoj pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset shoqërore, përmes së cilës pjesëmarrje avokohet për çështje sociale, politike, ekonomike, forcimin e parimit të transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve publike, rritjen e kërkesave të qytetarëve si dhe luftimin e korrupsionit, duke synuar në promovimin e vlerave të një shoqërie të hapur dhe demokratike.

Vizioni dhe misioni i organizatës përmbushet përmes aktiviteteve të ndryshme të punës të cilat organizohen nga dy (2) programet e specializuara të organizatës: 1. Qeverisja e Mirë dhe 2. Edukimi Demokratik.



 +383 (0) 49 354 000

 info@inpo-ks.org

 www.inpo-ks.org